



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 40, Datë 06.03.2020

MBI

MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO) SI DHE ROLET E PËRGJEGJËSITË E NEMO DHE OPERATORËVE TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË NË TREGUN E BASHKUAR.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 57 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, VKM Nr. 322, datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut”, nenit 19, pika 1, gërma f dhe nenit 26 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 06.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, nr. 36/2 Prot, datë 24.02.2020, mbi miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendim Nr. 240, datë 23.12.2019, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.
- Me shkresën nr. 32/62 Prot, datë 31.12.2019, është publikuar njoftimi në shtypin e shkruar me qëllim marrjen e opinioneve dhe komenteve nga palët e interesuara.
- Me shkresën Nr. 8 Prot. datë 06.01.2020 drafti i Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar i është përcjellë dhe palëve të interesit për opinione.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar për marrjen e opinioneve dhe komenteve rezultoi se nuk ka komente ose opinione nga palët e interesit për këtë rregullore.
- Bazuar në Urdhërin nr.33, datë 28.01.2020, në datën 31.01.2020, u realizua një seancë dëgjimore në ERE me pjestarët e tregut të energjisë elektrike. Në këtë seancë ishin ftuar për të marrë pjesë Përfaqësues të OST sh.a., KESH sh.a., Minsitrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe nga Autoriteti i konkurrencës.

- Përfaqsesit e KESH sh.a. dhe të OST sh.a. kërkuan në këtë seancë harmonizim të termave dhe përshtatje të tyre me aktet e tjera në fuqi. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë pasi ndikon në përmirësimin e terminologjisë së përdorur në rregullore dhe harmonizimin e saj me akte të tjera në fuqi. Element tjetër i propozuar në senacën dëgjimore ishte mundësia e implemetimit të plotë të Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve CACA (capacity allocation and congestion management).
- Në këtë kuadër ERE vlerëson si vijon: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka propozuar që në këtë rregullore të parashikohet edhe funksionimi i Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), siç është rekomanduar nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në mbledhjen e datës 24.04.2019, i cili ka mbështetur masat rregullatore për mbështetjen e implementimit të kushteve të Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë në palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë. Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (capacity allocation and congestion management) (CACM) përcakton qartë se për të bërë të mundur funksionimin e Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë të sektorit të energjisë elektrike në vendet anëtare të Sekretariatit dhe Bashkimit Evropian, duhet të përcaktohen përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmetimit (OST) dhe operatorëve të tregut të ditës në avancë (NEMO).
- Në rastin e vendit tonë duke marrë në konsideratë dhe sugjerimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe në vijim të procesit të hapur të konsultimit ku të vetmet komente janë ato të shprehura në sencën dëgjimore të datës 31.01.2020, është hartuar dhe përditësuar Rregullorja e Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe Rolet e Përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar. (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI

RREGULLORE E KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO) SI DHE ROLET E PËRGJEGJËSITË E NEMO DHE OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË NË TREGUN E BASHKUAR

Neni 1

Fusha e Veprimit

Kjo rregullore përcakton:

- i. Kushtet dhe procedurat për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjise Elektrike (NEMO) nga ERE.
- ii. Detyrat të cilat Operatori i Emëruar i Tregut të Energjise Elektrike (NEMO) duhet të kryejë në lidhje me procesin e bashkimit të tregut të energjise elektrike.
- iii. Detyrat që Operatori i Sistemit të Transmetimit do të kryejnë në lidhje me procesin e bashkimit të tregut të energjise elektrike.

Neni 2

Përkufizime

“Aplikues”: Është Subjekti i cili ka paraqitur aplikimin për tu përcaktuar si Operator i Emëruar i Tregut të Energjise Elektrike (NEMO).

“Rregullorja e Alokimit të Kapacitetive dhe Menaxhimit të Kongjestioneve” (CACM Regulation): Është Rregullorja e Komisionit të Bashkimit Europian 2015/1222 datë 24.07.2015 mbi krijimin e një udhëzuesi për alokimin e kapacitetive dhe menaxhimin e kongjestioneve.

“Të ardhurat e kongjestioneve”: Janë të ardhurat e krijuara si rezultat i alokimit të kapacitetive;

“Algoritmi i tregëtimit të vazhdueshëm”: Është algoritmi i përdorur në bashkimin e tregut brenda ditës (intra day) për plotësimin e kërkesave dhe alokimin në mënyrë të vazhdueshme të kapacitetive ndër-kufitare.

“Pale Qëndrore”: Janë subjekte që kanë për detyrë të nënshkruajnë kontrata me pjesëmarrësit e tregut, duke zëvendësuar kontratat që rezultojnë nga procesi i pajtueshmërisë si dhe organizimin e transferimit të gjendjeve neto që rezultojnë nga alokimi i kapacitetive me palët e tjera qëndrore ose me agjentët e transferimit;

“Afati i Tregut të Ditës në Avancë”: Është afati kohor i tregut të energjise elektrike deri në përfundim të kohës së paraqitjes së ofertave për tregun e një dite më përpara (day ahead), për çdo njësi kohe të tregut produktet e të cilat tregëtohen një ditë para se të shpërndahen;

“Bashkim i Tregut të Ditës në Avancë (Day Ahead)”: Është procesi i tregëtimit ku realizohet pajtueshmëria e kërkesave dhe kapacitetit ndër-zonal të alokuar për të njëjtën kohë për zona të ndryshme ofertimi në tregun e ditës në avancë;

“Bashkim i Tregut ne te njejten Dite (Intra day)”: Është procesi i vazhdueshem ku realizohet pajtushmeria e kerkesave dhe kapacitetit ndër-zonal te alokuar për zona të ndryshme ofertimi ne tregun brenda te njetes dite.

“Afati i tregut të energjisë elektrike”: Është afati kohor i paraqitjes së ofertave për tregun e ditës në avancë, në rastin kur për çdo njësi matëse të tregut, produktet tregëtohen një ditë para se të shpërndahen;

“Afati kohor i paraqitjes se ofertave për tregun e ditës në avancë”: Është afati kohor deri kur pranohen oferta/porosi në tregun e ditës në avancë;

“Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë (ECRB)”: Është Bordi Rregullator i Organizates Ndërkombëtare e cila është formuar sipas Traktatit te Komunitetit te Energjisë.

“Tepricat ekonomike vetem për bashkimin tregun të ditës në avancë ose bashkimin e tregut brenda te njetes ditës”: Është shuma e (i) tepricave të furnizuesit vetëm për bashkimin e tregut të ditës në avancë ose bashkimin e tregut brenda ditës për një periudhë të caktuar kohe, (ii) tepricat e konsumatorit për bashkimin e vetëm tregut të ditës në avancë ose bashkimin e tregut brenda ditës, (iii) të ardhurat e kongjestionave si dhe (iv) kostot dhe përfitimet e tjera që kanë lidhje në rastin kur kjo rrit eficiencën ekonomike për një periudhë të caktuar kohe. Teprica e furnizuesit dhe e konsumatorit eshte diferenca midis porosive të pranuar dhe çmimit te tregut për njësi te energjisë të shumezuar me volumin e energjisë elektrike te porosive;

“Afati kohor për tregun brenda ditës”: Është afati kohor i tregut të energjisë elektrike pas ores së hapjes ndër-zonale të ofertave për tregun intraday dhe para ores së mbylljes ndër-zonale të ofertave për tregun brenda te njetes dite, ku për çdo njësi kohe të tregut, produktet tregëtohen para shpërndarjes së tyre;

“Koha e hapjes per paraqitjen e ofertave ndër zonale ne tregun brenda dites”: Është koha kur kapaciteti ndër – zonal midis zonave të ofertimit hapet për një kohë të caktuar të tregut dhe një kufi te caktuar te zones se ofertimit.

“Koha e mbylljes per paraqitjen e ofertave ndër- zonale në tregun e te njetes dite”: Është koha kur alokimi ndër-zonal i kapacitetit perfundon dhe nuk pranohen alokime nder zonale për një kohë të caktuar të tregut;

“Funksion i Operatorit të Tregut të Bashkuar”: Është marrja e porosive dhe pajtueshmëria e tyre ne tregun e ditës në avancë dhe tregun brenda te njetes dite për zona të ndryshme ofertimit dhe alokimi i vazhdueshem i kapaciteteve nder – zonale.

“Pajtueshmëria/Perputhshmeri”: Është mënyra e tregëtimit përmes të cilës porosive te shitjeve i caktohen porosite e duhura te blerjeve për të siguruar maksimizimin e fitimit ekonomik për bashkimin e tregut të ditës në avancë ose bashkimin e tregut brenda ditës.

“Monopoli ligjor në vend”: Është caktimi i vetem një Operatori te Emëruar e Tregut të Energjisë Elektrike për sigurimin e shërbimeve të tregëtimit të ditës në avancë dhe/ose tregëtimin brenda ditës;

“Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”: Është subjekt ligjor i percaktuar nga Enti Rregullator i Energjise për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut te brenda te njetes dite sipas kesaj rregullore.

“Llogaritja e Kapacitetit Neto te Transmetimit (NTC)”: Është Kapaciteti Neto i Transmetimit i percaktuar me metodën e llogaritjes së kapacitetit bazuar ne parimin e vlerësimit dhe përcaktimit të shkëmbimit maksimal të energjisë midis zonave të ofertimit paraprakisht (**ex ante**).

“Porosi”: Është synimi për të blerë ose për të shitur energji ose kapacitet nga një pjesëmarrës tregu sipas kushteve të veçanta të realizimit.

“Algoritmi i çmimit të tregut te bashkuar”: Është algoritmi i përdorur për bashkimin e tregut të ditës në avancë për përputhjen e porosive dhe alokimin e kapaciteteve ndër – kufitare.

“Shlyerja (settlement)”: Është plotësimi i një transaksioni ose një procesi per likuidimin e detyrimeve te pjesëmarrësve te tregut përmes transferimit të fondeve dhe/ose garancive perkatese.

“Agjent transferimi” Është subjekt/subjekte që kanë për detyrë transferimin e pozicioneve neto ndermjet Paleve Qendrore të ndryshme.

“Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)”: Subjekt juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 3

Percaktimi i NEMO dhe revokimi i NEMO

1. Aplikimi për percaktimin dhe operimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) duhet të dergohet prane ERE me shkrim dhe përmes postës elektronike, ne adresen zyrtare te ERE.
2. Aplikuesi per qellim te aplikimit ne ERE duhet të përdorë formatin e Shtojcës 1.a. për të vertetuar permshushjen e kritereve te përmendura në Nenin 4 të kesaj rregullore si dhe duhet të paraqesë dokumentat e listuar ne Shtojcën 2 të kësaj rregullore.
3. Pas marjes së kërkesës/aplikimit për caktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), ERE duhet të marrë vendimin për caktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike për shërbimet e tregëtimit të ditës në avancë dhe brenda te njejtës ditës brenda dy muajve. Vendimi i ERE bazuar ne legjislacionin ne fuqi percakton dhe natyren monopol te Operatorit te Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike.
4. Përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e Rregullores së Alokimit të Kapacitetieve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve në legjislacionin e vendit, sipas të cilës përcaktimi i NEMO duhet të konfirmohet bazuar ne Rregulloren e Alokimit të Kapacitetieve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM Regulation).
5. Në rastin kur ka disa aplikues për Operatorin e Emëruar (nominuar) të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), ERE do të përcaktojë si NEMO, aplikuesin i cili permshush kriteret e përmendura në Nenin 4 te kesaj rregullore. ERE duhet te trajtoj ne menyre te barabarte te gjithë aplikuesit dhe të shmangët çdo diskriminim ne kete proces.
6. ERE do te revokojë përcaktimin e bere per NEMO, nëse Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike i percaktuar sipas kesaj rregullore nuk i permshush kriteret e pajtueshmerise

sipas Nenit 4 dhe nuk është në gjendje të përmbushë perseri këto kritere brenda gjashtë muajve pasi është njoftuar nga ERE për mospërmbushjen e kritereve të pajtueshmërisë.

7. ERE do të publikojë përcaktimin dhe revokimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) në faqen e vet zyrtare si dhe do të njoftojë ECRB.

8. ERE do të vendosë ose do të miratojë një tarifë të mjaftueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për tregëtimin në tregun e ditës në avancë dhe tregun e brenda të njëjtes dite, para fillimit të funksionimit si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike, ose ERE do të përcaktojë metodologjinë për të përllogaritur tarifën përkatëse.

Neni 4

Kriteret për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike

1. Aplikuesi duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme për të përcaktuar si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike:

- a. Ka kontraktuar ose do të kontraktojë burimet e duhura për operimin e përbashkët, të koordinuar dhe të pajtueshëm të tregut të ditës në avancë dhe/ose të tregut brenda të njëjtes dite, duke përfshirë burimet e nevojshme financiare, teknologjinë e nevojshme të informacionit, infrastrukturën teknike dhe procedurat operacionale ose duhet të sigurojë prova që është në gjendje të vendosë në dispozicion këto burime brenda një periudhe të arsyeshme përgatitore para fillimit të ushtrimit të funksioneve të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike sipas përcaktimeve të Nenit 5;
- b. Duhet të jetë në gjendje të sigurojë akses të hapur për informacion për pjesëmarrësit e tregut në lidhje me detyrat e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) sipas përcaktimeve të Nenit 5;
- c. Duhet të jetë me kosto eficiente në lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda të njëjtes dite dhe duhet të mbajë llogari të ndara për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar dhe veprimtaritë e tjera me qëllim parandalimin e ndër-subvencioneve;
- d. Duhet të ketë aktivitet të ndare nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut;
- e. Nuk përdor tarifën e përcaktuar sipas Nenit 3 pika 8 për të financuar veprimtaritë e tregëtimit të ditës në avancë dhe atij brenda të njëjtes dite tek një Palë tjetër, përveç palet nga e cila ka mbledhur/marrë tarifën.
- f. Duhet të jetë në gjendje të garantojë trajtim të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë jo diskriminuese.
- g. Duhet të ketë rregulla dhe organizimin e përshtatshëm për mbikqyrjen e tregut.
- h. Duhet të ketë marrëveshje të duhura të transparencës dhe konfidencialitetit me pjesëmarrësit e tregut dhe OST.
- i. Duhet të jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e nevojshme të likuidimit dhe të shlyerjes së detyrimeve.
- j. Duhet të jetë në gjendje të vendosë sistemet dhe rregullat e nevojshme të komunikimit për të koordinuar me OST.

Detyrat e NEMO

1. Operatorët e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMOs) duhet të veprojnë si operatorë të tregut ne tregun lokal ose tregun rajonal për të kryer në bashkëpunim me OST lokal ose OST rajonal bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda te njejtës dite. Detyrat e tyre do të përfshijë marrjen e porosive nga pjesëmarrësit e tregut, për të patur një përgjegjësi teresore për përputhjen dhe ndarjen e porosive sipas rezultateve të tregut të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës dite, për të publikuar çmimet dhe shlyerjen e kontratave që rezultojnë nga tregëtimi sipas marrëveshjeve dhe rregulloreve perkatëse me pjesëmarrësit.

Në lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës dite, NEMO do të jetë veçanërisht përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

- a. Zbatimin e funksioneve të Operatorit të Tregut të Bashkuar, të përcaktuara në paragrafin 2 në koordinim me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- b. Zbatimin e kërkesave për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës ditë, si dhe kërkesat për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar për çmime të perbashkëta, të përcaktuara sipas algoritmit të vendosur dhe që aplikohet në vendet e Bashkimit Europian (BE). Ndjekjen e të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e tregut të energjisë elektrike në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni.
- c. Zbatimin e çmimeve maksimale dhe minimale ashtu si aplikohet në BE në përputhje me çmimet maksimale dhe minimale të përcaktuara sipas standarteve në BE ose standarteve të rajonit.
- d. Ruajtjen e anonimitetit, që nënkupton se nuk mund të lidhet me pjestar të vecant të tregut, si dhe nuk do të zbuloj informacionin për porositë të marrë të shprehur në Euro, i cili është i nevojshëm për të kryer funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar të parashikuar në paragrafin 2 të këtij Neni.
- e. Vlerësimin e rezultateve të llogaritura bazuar në funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Neni, alokimin e porosive bazuar në këto rezultate, përcaktimin e rezultateve si përfundimtare nëse ato konsiderohen të sakta dhe dërgimin e tyre në OST-te, të cilat duhet t'i vlerësojnë ato në përputhje me mundësitë e alokimit të kapacitetit ndër zonal të disponueshëm.
- f. Informim i pjesëmarrësve të tregut në lidhje me rezultatet e porosive të tyre pa vonesa të pajustificueshme.
- g. Të veprojnë si palë qendrore për shlyerjen dhe realizimin e shkëmbimit të energjisë e cila rezultojnë nga bashkimi i tregut të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës dite sipas metodologjisë së hartuar në vende të BE.
- h. Të miratojnë dhe të zbatojnë së bashku me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe OST -te procedurat përkatëse rezerve (**back up**) për operimin e tregut kombëtar ose rajonal nëse rezultatet nuk vendosen në dispozicion nga Operatori i Tregut të Bashkuar duke patur parasysh procedurat rezerve të dakordësuara nga OST. Këto procedura rezervë në nivel kombëtar dhe rajonal duhet të lejojnë ndarjen e kapacitetit në rastin kur procedurat e bashkimit të tregut nuk janë në gjendje të japin rezultate.
- i. Të sigurojnë parashikimin e kostove për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës dite dhe informacionin për kostot ta vëre në dispozicion të Autoritetit Rregullator

(ERE) dhe për OST-të, ne rastet kur kostot e NEMO për krijimin, ndryshimin dhe funksionimin e bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda te njejtës dite, do të mbulohen nga kontributi i OST-ve në fjalë.

- j. Të koordinohet me OST-të për të krijuar marrëveshje në lidhje me operimin e më shumë se një NEMO brenda një zone ofertimi dhe të kryejë bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe /ose atij brenda te njejtës dite në përputhje me marrëveshjet ne fuqi. Këto marrëveshje do të jenë në përputhje me praktikat më të mira për marrëveshjet me shumë NEMO. Marrëveshjet do të përmbajnë propozime për llogaritjen dhe ndarjen (alokimin) e kapacitetit ndër zonal dhe rregullimet e tjera të nevojshme për këto zona ofertimi në bashkëpunim me OST-të dhe NEMO-t e interesuara, si dhe te sigurojnë që OST-të dhe NEMO-t ofrojnë të dhënat e nevojshme per mbulimin financiar për keto marrëveshje të cilat lejojnë disa NEMO ne një zonë ofertimi. Këto marrëveshje do të lejojnë që OST-të dhe NEMO-t e tjera tu bashkohen këtyre marrëveshjeve në të ardhmen.
- k. Të kryej rolin e një agjenti të transferimit, nëse vendoset nga Autoriteti Rregullator ERE.

2. Operatorët e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike duhet të kryejnë funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) së bashku me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike. Këto funksione duhet të përfshijnë:

- a. Të zbatojë algoritmet, sistemet dhe procedurat për bashkim e tregu të ditës në avancë dhe/ose bashkimin e atij brenda te njejtës dite siç përcaktohet dhe ne vendet te BE. Nëse bashkimi i tregut midis dy ose më shumë zonave të ofertimit nuk përfshin një shtet anëtar të BE në hapin e parë, duhet të dakordesojë një zgjidhje të përkohshme e cila duhet të zbatohet pas miratimit nga ERE. Kjo zgjidhje duhet te percaktohet në bashkëpunim të ngushtë me OST dhe NEMO e tjera të përfshira, ne keto kushte krijohet mundesia qe algoritmet, sistemet dhe procedurat për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe / ose bashkimit të atij brenda ditës që zbatohen në BE te zbatohen dhe ne kete rast per aq sa eshte e mundur, ndërkohë që lejohen veçoritë e dy zonave të ofertimit.
- b. Përpunimi i të dhënave hyrëse mbi kapacitetin ndër-zonal si dhe kufizimet e mundeshme të parashikuara në procesin e llogaritjes së koordinuar të kapacitetit nga OST ose llogaritësi i koordinuar i kapacitetit që vepron në emër të OST. Këto të dhëna duhet t'i dorëzohen NEMO-ve përkatëse jo më vonë se një orë para kohës së mbylljes së tregut të ditës ne avance dhe jo më vonë se 15 minuta afatit kohor te hapjes së tregut brenda të njejtës dite.
- c. Operimin me çmime te përbashkëta dhe algoritmet e përputhjes së vazhdueshme të tregëtimit sipas standarteve të BE. Nëse bashkimi i tregut midis dy ose më shumë zonave të ofertimit nuk përfshin një shtet anëtar të BE hapi i parë, është dakordësia e një zgjidhje e përkohshme e cila do të zbatohet pas miratimit nga ERE. Kjo zgjidhje percaktohet në bashkëpunim të ngushtë me OST dhe NEMO e tjerë të përfshirë, që mundeson qe algoritmet te cilat zbatohen në BE te aplikohen për aq sa është e mundur dhe ne kete rast, ndërkohë që lejojnë veçoritë e dy zonave të ofertimit.
- d. Verifikimi dhe dërgimin i rezultateve të bashkimit të tregut të ditës në avance dhe tregut brenda te njejtës dite tek NEMO-t dhe OST-te.

3. Bashkëpunimi midis NEMO-ve do të kufizohet vetem ne ate pjese që është e nevojshme për hartimin, zbatimin dhe funksionimin efikas dhe të sigurt të bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës dite. Performanca e përbashkët e funksioneve të Operatorit të Tregut te Bashkuar (MCO) bazohet në parimin e mos diskriminimit dhe siguron që asnjë NEMO nuk mund të përfitojë nga avantazhet e pajustificuara ekonomike përmes pjesëmarrjes ne funksionet e MCO. Kjo kryesisht do të ndalojë përdorimin e informacionit nga zoteruesit te ketij ionformacioni (NEMO) i cili që nuk është i hapur për publikut për ti dhënë avantazh të padrejtë ndaj konkurentëve ekzistues ose të mundshëm ose te përdoret për të maksimizuar fitimin ekonomik.

Neni 6

Detyrat e OST në lidhje tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe brenda te njejtës dite

1. Pasi është caktuar Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) sipas kësaj rregullore, OST duhet të marrë pjesë në bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës dite. OST do të koordinojnë me NEMO për të siguruar operimin eficient të tregut te bashkuar.

2. Detyrat qe OST do të realizoje:

- a. Do të punojë me OST-të e Palëve Kontraktore të Komunitetit të Energjisë dhe/ose Shtetet Anëtare të BE për të siguruar funksionimin e një çmimi të përbashkët dhe vazhdueshmerine e alogaritmit te tregëtimit për të gjitha aspektet që kanë lidhje me alokimin e kapacitetit përcaktuar sipas standarteve të BE.
- b. Do të kontribojë për miratimin e përbashkët të algoritmeve te pajtueshmërisë sipas kërkesave te përcaktuara në BE.
- c. Në bashkëpunim me OST e tjera do të kryejë llogaritjen e kapacitetit neto (**net transfer capacity NTC**) per D-2 për të mbështetur bashkimin e tregut.
- d. Do të llogarisë, në bashkëpunim me OST-të e tjera kapacitetet ndër-zonale dhe kufizimet e tyre për NEMO përkatëse jo më vonë se 1 orë para mbylljes së ofertave për tregun e ditës në avancë. Nëse OST nuk është në gjendje ti ofrojë këto të dhëna sipas ketij afati, duhet të njoftojnë NEMO respektive dhe duhet ti ofrojnë të dhënat jo më vonë se 30 minuta para mbylljes së ofertave për tregun e ditës në avancë.
- e. Do të kontrollojë rezultatet e bashkimit të tregut të ditës në avancë në lidhje me kapacitetet ndër-zonale.
- f. Do të respektojë rezultatet e bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe të tregut brenda te njejtës dite të llogaritura sipas gërmes (e) të këtij Neni.
- g. Do të krijojë dhe vendosë në funksion procedurat mbështetëse sipas rastit për alokimin e kapacitetit.
- h. Do të dakordësojë me OST e tjera dhe të propozojë kohen e hapjes ndër-zonale të ofertave për tregun e te njejtës dite dhe kohën e mbylljes ndër-zonale të ofertave për tregun e te njejtës dite ne te njejtën linje me metodologjite e aplikuar ne BE.
- i. Do të ndajë të ardhurat e kongjestionit sipas metodologjisë së miratuar me OST respektive sipas metodologjive të BE.
- j. Në rastin kur është rënë dakord, do të veprojë si agent transferimi për transferimin e pozicioneve neto ne treg.
- k. Do të luajë rolin e agjentit të transferues nëse është vendosur nga ERE.

Shtojca 1.a

Modeli i Formularit të Aplikimit

1. Informacion ligjore per subjektin aplikues:

- a) **Emri i subjektit aplikues:** [vendosni emrin e subjektit]
- b) **Adresa e aplikuesit:** [vendosni adresën në të cilën është regjistruar aplikuesi]

2. Informacioni i kontaktit i aplikuesit

- a) **Emri i personit të kontaktit** [vendosni emrin e personit të kontaktit]
- b) **Pozicioni i personit të kontaktit** [vendosni pozicionin qe mban personi i kontaktit]
- c) **Numri i telefonit të personit të kontaktit:** [vendosni numrin e telefonit të personit të kontaktit]
- d) **Adresa e email-it e personit të kontaktit:** [vendosni adresën e email-it të personit të kontaktit]
- e) **Adresa postare e personit të kontaktit:** [vendosni adresën postare të personit të kontaktit]

3. Deklaratë nëse aplikuesi po aplikon për tu percaktuar si NEMO për tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe/ose atij brenda te njejtës ditë:

Subjekti po aplikon për tu percaktuar si Operator i Tregut të Enegjisë Elektrike për të funksionuar në tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe atij brenda te njejtës dite;

Nëse ekziston më shumë se një zonë Ofertimi tregoni për cilën zonë ofertimi po bëhet aplikimi:

[Vendosni se për cilën zonë ofertimi nevojitet ky aplikim]

4. A ka aplikuar subjekti aplikues për tu percaktuar caktuar si Operator i Emëruar i Tregut te Enegjisë Elektrike (NEMO) tek një palë tjetër dhe nëse po tek cila palë/zonë ofertimi:

[Vendosni emrin e palës & zonën e ofertimit për të cilën ka aplikuar subjekti]

A është refuzuar ndonjë aplikim, nëse po për cilën palë dhe për çfare arsye:

[Vendosni palën dhe arsyen e refuzimit]

5. Deklaratë nëse subjekti është aktive si një monopol ligjor në një treg tjetër:

Subjekti nuk është aktiv si një monopol ligjor në një treg tjetër

Subjekti është aktive si një monopol ligjor tek [vendosni tregun].

6. Deklaratë nëse i gjithë ose një pjesë e aplikimit është konfidenciale, arsyet përse dhe cili paragraf:

a) **A përmban aplikimi informacion konfidencial:**

b) Po/Jo

c) **A është i gjithë apo një pjesë e aplikimit konfidencial:**

Gjithë/ Një pjesë e aplikimit janë konfidenciale.

Nëse vetëm disa pjesë të aplikimit janë konfidenciale ju lutem nënvijëzoni ato në tekst.

d) **Arsyetimi për konfidencialitetin:**

[Vendosni arsyetimin për konfidencialitetin]

7. Nënshkrimi dhe deklarata për saktësinë e informacionit të paraqitur:

Unë, [vendosni emrin], jam autorizuar të paraqes aplikimin për emërim si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe garantoj që informacioni dhe dokumentat e paraqitura si pjesë e këtij aplikimi janë të vërteta, korrekte dhe përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm të njohur nga [Emsri i Subjektit] në mënyrë që ERE të vlerësojë aplikimin e [Emri i subjektit].

[Firma, emri i nënshkruesit të autorizuar dhe pozicioni, vendi dhe data]

Lista e dokumentave të paraqitur si pjesë e këtij aplikimit:

[Lista e dokumentave]

Shtojca 1.b

Interpretim i Nenit 4 dhe dokumentave mbështetëse të cilat duhen të paraqiten në përputhje me të, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mirë nga Shtetet Anëtare të BE

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.a:

Aplikuesi ka kontraktuar ose do të kontraktojë burimet e duhura për funksionimin e perbashket, të koordinuar dhe të pajtueshem të tregut të bashkuar të ditës në avancë dhe/ose brenda të njëjtes dite, duke përfshirë burimet e nevojshme për të përmbushur funksionet e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), burimet financiare, teknologjinë e nevojshme të informacionit, infrastrukturën teknike dhe procedurat funksionale ose duhet të vërtetojë që është në gjendje të vendosë këto burime në dispozicion brenda një periudhe përgatitore të arsyeshme përpara se të fillojë funksionet e tij si NEMO.

Interpretimi perkates:

Aplikuesit duhet të përfshijnë informacion në lidhje me:

- Garantimin e kapitalit të mjaftueshëm dhe siguri financiare për të mbuluar shpenzimet e aktiviteteve dhe ekspozimin ndaj riskut në mënyrë që të drejtojë bashkim eficient, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të tregut të ditës në avancë dhe/ose atij brenda të njëjtes dite;
- Të ketë platformat e nevojshme për përdorim dhe bashkeveprimet perkatese, që përfshijnë informacionin e nevojshëm teknologjik (software), pajisjet teknike (hardware dhe infrastrukturën), dhe/ose marrëveshjet kontraktore për shërbimin me standarte dhe për sigurimin e këtyre shërbimeve, së bashku me planet për rastet emergjente (**contingency**), për të siguruar bashkim eficient, të sigurt dhe të qëndrueshëm të tregut të ditës në avancë dhe/ose atij brenda të njëjtes dite;
- Të ketë marrëveshjet funksionale të nevojshme dhe marrëveshjet kontraktore me Operatorët e Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe pjesëmarrësit e tjerë përkatës të tregut si edhe planet për rastet emergjente, që tregojnë mënyrën si një Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) do të përmbushë detyrimet e përcaktuara:
 - Ato duhet të përfshijnë detyrimin që aplikuesi ka nënshkruar ose do të nënshkruajë marrëveshjet e kërkuara funksionale ose kontraktore në rastin kur operon më shumë se një Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) në një zonë ofertimi;
 - Gjithashtu duhet të përfshijë dëshmi që janë bërë parashikimet të cilat mundësojnë Operatorëve të rinj të Sistemit të Transmetimit dhe Operatoreve të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) të nënshkruajnë të njëjtat marrëveshje.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Çertifikatën e regjistrimit;
2. Evidenca se është kuptuar mjaftueshëm legjislacioni përkatës;
3. Raporti vjetor i vitit të fundit i audituar;

4. Plani financiar që projekton të ardhurat e këtij viti dhe të vitit pasardhës që nevoiten për kryerjen e detyrave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) di cili përbehet nga:
 - a. Pasqyren e Pozicionit Financiar;
 - b. Pasqyren e fitimit dhe- humbjeve dhe të Ardhurave gjithpërfshirëse,
 - c. Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital;
 - d. Deklarim i qartë i supozimeve që janë përdorur si baze të planifikimeve;
 - e. Një analizë studimore e parashikimit të ndryshimeve të dhëna sipas supozimeve të dhëna;
 - f. Një analizë e qartë e mënyrës se si aplikuesi planifikon të financojë operimin / funksionimin duke përfshirë detajet e garancive që kanë marrë aplikuesit për të përdorur.

5. Një Plan Biznesi i cili lidhet me detyrat e tij si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që përfshin:
 - a. Një analizë të detajuar operacionale ku përfshihen proceset kryesore të NEMO;
 - b. Një përshkrim të qartë dhe shpjegim se si do të funksionojë tregu i bashkuar i ditës në avance dhe/ose atij brenda të njëjtes dite duke përfshirë strukturën organizative;
 - c. Strukturën organizative përfshirë personelin dhe burimet njerezore për funksionimin dhe në mënyrë të veçantë ato që kanë lidhje me ofrimin e shërbimit IT;
 - d. Kodin e sjelljes dhe programin e pajtueshmërisë;
 - e. Synimin, natyrën, dhe qëllimin e caktimit të detyrave që do të kryhen nga palët e treta dhe procedura të cilat aplikuesit synojnë të përdorin për të mundur ofrimin e shërbimit për palët e treta;
 - f. Shpjegim i detajuar i sistemeve teknike dhe IT me qëllim për tu përdorur dhe besueshmërinë funksionale të sistemeve në fjalë;
 - g. Aplikuesi do të paraqesë masat me të cilat do të identifikojë, menaxhojë dhe të shmangë konfliktin e interesit;
 - h. Shpjegim i detajuar i planit se si aplikuesi ka për qëllim të bashkëpunojë me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe do të dokumentojë që çdo marrëveshje për këtë qëllim do të jetë në fuqi jo më vonë se 2 muaj pasi të jetë miratuar përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO);
 - i. Shpjegim të detajuar në lidhje me procesin e identifikimit dhe menaxhimit të rikutit si dhe planifikimit të përshtatshëm të menaxhimit të rasteve emergjente.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.b:

Aplikuesi të jetë në gjendje të sigurojë që pjesëmarrësit e tregut të kenë akses të hapur tek informacioni për sa i përket detyrave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) sipas përcaktimeve të Nenit 7.

Interpretimi përkatës:

Aplikuesi duhet të vërtetojë dhe sigurojë që do të jenë në gjendje të publikojnë informacionin dhe të dhënat në mënyrë të hapur (te tilla siç janë, marrëveshjet, metodologjitë, rregullat, procedurat dhe të dhënat) ashtu sic kërkohen dhe që ky akses do të jetë në dispozicion në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një strategji të qartë komunikimi që përfshin:
 - a. Përshkrim dhe dëshmi për vendin dhe mënyrën si pjesëmarrësit e tregut do të kenë mundësinë për të patur akses në informacion;
 - b. Proçesin e publikimit të të dhënave;
 - c. Përshkrim i planeve për rastet emergjente dhe garancia që ky informacion është në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve të tregut.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.c:

Bashkimi i tregut të ditës në avancë dhe atij brenda të njëjtes dite duhet të jetë me kosto eficiente dhe duhet të mbajë llogari të veçanta për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe aktiviteteve të tjera në mënyrë që të parandalojë ndër-subvencionimin.

Interpretimi perkates:

Aplikuesi duhet të përfshijnë prova që ka llogari të veçanta për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe aktivitetet e tjera të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektike (NEMO) dhe duhet të bëjë një analizë të qartë të të gjitha shpenzimeve të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). Kjo do të mundesoje që ERE të përcaktojë se në çfarë niveli ofrimi i shërbimeve është me kosto eficiente. Kjo mund të realizohet ose me anë të krahasimit me aplikime të tjera, nëse paraqitet më shumë se një aplikim, ose nëpërmjet bashkëpunimit me Autoritete të tjera Rregullatore të cilat më herët kanë caktuar NEMO.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të proçeseve të llogaritjes të cilat do ti japin mundësinë aplikuesit të identifikojë dhe ndajë kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektike (NEMO);
2. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të llogarive të veçanta të cilat do të përdoren për kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
3. Përshkrim të qartë të proçeseve të raportimit të një analizimi të qartë të të gjitha kostove të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë shpenzimet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO);
4. Një krahasim i kostove të aplikuesit në lidhje me shembujt respektiv në Bashkimin Europian (BE) me kosto të ndara të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO).

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.d:

Aplikuesi do të ketë një nivel të përshtatshëm të ndarjes së biznesit nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Interpretimi perkates:

Aplikimi duhet të përfshijnë prova të një ndarjeje të mjaftueshme të biznesit në masën që çdo biznes i lidhur të mos ketë mundësinë të përdorë informacionin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) që nuk janë hapura për publikun për avantazhin e tyre të padrejtë. Kjo nënkupton që aplikuesi duhet të përfshijë, për transparencë, çdo të dhënë për konflikt interesi të mundshëm që mund të ngrihet nga pronësia apo lidhja me pjesëmarrës të tregut. Aplikuesi nuk duhet të ndajë informacionin me ose pa qëllim për të favorizuar një pjesëmarrës të tregut i cili mund të jetë pronari ose të ketë lidhje me aplikuesin. Përveç kësaj, në rastet kur aplikuesi ka një konflikt interesi të mundshëm, aplikuesi duhet të paraqesë procesin dhe mekanizmin për të siguruar një ndarje të mjaftueshme dhe eliminim të konfliktit të interesit.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të strukturës së aplikuesit duke përfshirë, përbërjen e bordit të tij drejtues ose organet e tjera qeverisëse, drejtorët si dhe, nëse është e mundur, interesin e tyre në treg pavarësisht lidhjes së tyre me aplikuesin;
2. Informacion në lidhje me biznese të tjera të mundshëm të aplikuesit përveç shërbimeve të tregut të ditës në avancë dhe brenda te njejtës dite;
3. Deklaratë nëse aplikuesi është duke bashkëpunuar me pale të tjera dhe nëse po çfarë aktiviteteve po ndërmerr me këto palë;
4. Një përmbledhje e plotë e të gjitha insitucioneve në vartësi funksionale të pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
5. Informacion në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotuesve direkte dhe indirekte, pale të tjera të lidhura ligjrisht, kompanitë mëmë, dhe filialet e tyre;
6. Në rast se aksionerët, palët e tjera ligjore, kompanitë mëmë, ose filialet janë pjesëmarrës të tregut, duhet të shpjegohet sesi aplikuesi ka organizuar ndarjen e biznesit dhe eliminimin e konfliktit të interesit.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.e:

Aplikuesi nëse është i përcaktuar si një monopol ligjor kombëtar për shërbimet e tregëtimit të ditës në avancë dhe atyre brenda te njejtës dite tek një Palë Kontraktuese, nuk do të përdorë tarifën e përcaktuar në Nenin 5(1) për të financuar aktivitetet e tregjeve të ditës në avancë dhe brenda te njejtës dite tek një Palë tjetër Kontraktore përveç se aty ku janë mbledhur këto tarifa.

Interpretimi i perkates:

Aplikuesi nëse është përcaktuar si një monopol në vend duhet që, të paraqesë dokumentacion që vërteton se ka llogari të vecanta për shërbimet që funksionon si një monopol ligjor në vend dhe llogari të vecanta për shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe ato brenda te njejtës dite nga cdo shërbime apo cdo aktivitet tjetër.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një përshkrim dhe shpjegim të qartë të proceseve të tij të llogaritjes për çdo njërin prej aktiviteteve ligjore monopol.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.f:

Aplikuesi duhet të jetë në gjendje të trajtojë të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë të barabarte dhe jo – diskriminuese.

Interpretimi perkates:

Aplikuesi duhet të paraqesin prova që ata mund dhe do të trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit e tregut në të njëjtën formë në mënyrë të barabarte dhe jo diskriminuese. Kjo duhet të përfshijë procedura të cilat mundesojnë që pjestaret e rinj në treg të lejohen të futen në treg me të njëjtat marrëveshje sikurse aplikohet për pjesëmarrësit ekzistues të tregut.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një shpjegim të detajuar të procedurave për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar dhe që do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk lejojnë diskriminimin e pjesëmarrësve të tregut;
2. Rregullat e tregut të cilat do të aplikohen për të gjithë pjesëmarrësit e tregut duhet të sigurojnë që nuk do të ketë diskriminim në treg;
3. Procedurat e brendshme duhet të përcaktohen me shkrim si dhe marrëveshjet funksionale, marrëveshjet kontraktore, dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut të duhet mos jenë diskriminuese.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.g:

Aplikuesi do të ketë mekanizma dhe marrëveshje të duhura për realizimin e mbikqyrjes së tregut.

Interpretimi perkates:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata kanë zbatuar ose do të zbatojnë një program trajnimit dhe procedura monitorimi të cilat do të lejojnë aplikuesit të identifikojnë dhe raportojnë çdo çështje të mundshme në lidhje me integritetin e tregut të energjisë elektrike me shumicë si dhe parimet e transparencës dhe ato të mos diskriminimit.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Interpretim i detajuar i programeve të trajnimit duke përfshirë:
 - a. Nëse drejtuesit dhe punonjësit kanë ose do të kenë njohje të marrëveshjeve të mbikqyrjes së tregut;
 - b. Nëse drejtuesit dhe punonjësit janë ose do të jenë në dijeni për çështjet e mbikqyrjes së tregut, psh. çështjet e Rregullores së Transparencës dhe Integritetit së Tregut të

Energjisë Elektrike me Shumicë (**REMIT Regulation on Wholesale Energy Market Integrity and Transparency**);

- c. Nese drejtuesit dhe punonjësit janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për të raportuar çdo çështje të mundshme gjate mbikqyrjes së tregut.
2. Interpretim të qartë dhe të detajuar si dhe shpjegim të skemave të monitorimit dhe proceseve qe lidhen me:
- a. grumbullimin e informacionit;
 - b. monitorimin e aktiviteteve të tregëtimit;
 - c. identifikimin e rasteve të mundshme;
 - d. vlerësimin dhe hetimin të rasteve të mundshme;
 - e. vleresimin e përshkallëzuar të çështjeve të brendshme të mundshme duke bashkepunuar me autoritetet përkatëse;
 - f. percaktimin se kush nga aplikuesi do të mbajë përgjegjësinë kryesore per keto procese dhe nëse do të krijohet një njësi e vecante për këtë çështje.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.h:

Aplikuesi duhet të kete te percaktuara mekanizmat dhe marreveshjet e duhura per transparencën dhe konfidencialitetin me pjesëmarrësit e tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Interpretimi perkates:

Aplikuesit duhet të tregojne që ata kanë ose do të zbatojnë ose do të nenshkruajne së bashku me pjesëmarrësit përkatës të tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit marrëveshje të cilat do të përfshijnë transparencën dhe konfidencialitetin e të gjitha palëve të përfshira.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Interpretim të detajuar të mënyrës se si aplikuesit do të vlerësojnë, miratojnë dhe zbatojnë marrëveshjet për transparencë dhe konfidencialitet me pjestarët aktuale dhe të ardhshëm të tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.
2. Të paraqesë çdo marrëveshje ekzistuese që eshte ne zbatim.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.i:

Aplikuesi duhet të jetë në gjendje të ofroje sherbimet e shlyerjes

Interpretimi perkates:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata janë ose kanë kontraktuar një subjekt i cili është në gjendje të ofrojne:

- Kapital të mjaftueshëm dhe siguri financiare, së bashku me procedurat për të siguruar garanci të kënaqshme për shlyerjet, të nevojshme për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë që rezulton nga bashkimi i tregut të ditës në avancë dhe/ose tregut brenda te njejtës dite.

- Marrëveshjet teknike, operacionale dhe kontraktuale për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë elektrike që rezulton nga tregu i ditës në avancë dhe/ose tregu i brenda te njetes dite. Në mënyrë të veçantë aplikantët të cilët aplikojnë për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe/ose atij brenda ditës duhet të vërtetojnë që ata kanë ose do të hyjnë në marrëveshje operacionale/kontraktuale të cilat lejojnë më shumë se një Operator të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) të operojë tregun e ditës në avancë dhe/ose tregun brenda te njetes dite.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Shpjegim i detajuar i kostove të operimit dhe kërkesave të kolateralit si dhe mbajtja e tyre;
2. Përshkrim dhe shpjegim i qartë i proceseve për të vendosur se cilat garanci nevojiten për shlyerje (likuidim);
3. Vlerësim i riskut dhe analizë studimore e bërë për të treguar perballimin e riskut në vazhdim;
4. Përshkrimi i qartë dhe shpjegimi i mënyrës se si aplikuesit duhet planifikojnë të realizojnë pagesën dhe shlyerjen, përfshirë:
 - a. Rregullat që aplikohen;
 - b. Kërkesat e pjesëmarrësve,
 - c. Proceset për pagesën dhe shlyerjen e detyrimeve, përfshirë atë me Operatorët tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.
5. Përshkrimin e qartë dhe shpjegimin e marrëveshjeve kontraktuale të nevojshme për të siguruar proceset e shlyerjes dhe likuidimit, përfshirë NEMO dhe OST e tjera dhe konfirmimin për marrëveshjet e operimit dhe ato kontraktuale të cilat lejojnë ose do të mundësojnë NEMO dhe OST e tjera që të funksionojnë në tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe/ose atë brenda te njetes dite.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.j:

Aplikuesi do të jetë në gjendje të vendosë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe praktikat për koordinim me Operatorët e Sistemit të Transmetimit

Interpretimi perkates:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata janë në gjendje të vendosin komunikimin e nevojshëm, sistemet teknike dhe marrëveshjet për tu koordinuar me Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këtë pajisje;
2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimit të menaxhimit të riskut.

3. Dokumentin e OST përkatëse ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi i OST që kjo mënyrë, software dhe hardware janë të pranueshme per OST.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.2:

Aplikuesi të jetë në gjendje të vendosë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe praktikat për kordinim me Operatorët e Sistemit të Transmetimit

Interpretimi i Perkates:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata janë në gjendje të vendosin komunikimin e nevojshëm, sistemet teknike dhe marrëveshjet perkatese për tu kordinuar me Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këto pajisje;
2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe menaxhimit të riskut.
3. Dokumentin e OST përkatëse ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi që kjo mënyrë, software dhe hardware janë të pranueshme per OST.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.2:

Aplikuesi do të jetë në gjendje të vendosë sistemet e nevojshme të komunikimit dhe praktikat për kordinim me Operatorët e Sistemit të Transmetimit

Interpretimi perkates:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë që ata janë në gjendje të vendosin komunikimin e nevojshëm, sistemet teknike si dhe marrëveshjet perkatese për tu kordinuar me Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këto pajisje;
2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimit i menaxhimit te riskut.